



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF ADVOCATES
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

Prishtinë, rr. (Bedri Pejani Nr. 31)

Tel/fax 038/244-586

ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS

KODI I ETIKËS PROFESIONALE TË AVOKATIT

Prishtinë, Kosovë

23.03.2019

I. PARIMET THEMELORE

Neni 1

Kodi i etikës profesionale të avokatit (në tekstin e mëtejme Kodi) përcakton parimet dhe rregullat e sjelljes me qëllim të ruajtjes së nderit, dinjitetit dhe prestigjit të avokatisë.

Neni 2

Parimet themelore të përcaktuara me Ligj, Statut dhe Kod dhe aktet tjera normative, duhet të jenë pjesë përbërëse e vetëdijes dhe bindjes së secilit avokat. Mosnjohja e këtyre parimeve nuk e arsyeton avokatin për çfarëdo shkelje të dispozitave të tyre.

Neni 3

Avokati vazhdimisht duhet t'i thellojë njohuritë e tij, duhet ta përcjellë literaturën dhe çdo ngjarje profesionale, përparimin shkencor dhe kulturor. Sipas mundësive të veta dhe kompetencës profesionale avokati duhet të marrë pjesë dhe t'ia ofrojë bashkëpunimin e tij, Odës së Avokatëve dhe shoqatave të tjera profesionale.

Neni 4

Avokati në cilësinë e ekspertit mund të angazhohet si këshilltar, bashkëpunëtor, anëtar i ndonjë organi ligjvënës, trupave profesionale, grupeve të punës me karakter qeveritar dhe joqeveritar, në organizata humanitare, organizata për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, këshillave botuese, anëtarë apo këshilltar në ndonjë organizatë për ofrimin e njohurive profesionale me kusht që kjo të mos jetë marrëdhënie e rregullt e punës apo në kundërshtim me profesionin e avokatit.

Neni 5

Qëndrimi i avokatit ndaj palëve, institucioneve dhe autoriteteve tjera duhet të jetë në pajtim me aktet normative të OAK.

Neni 6

Në paraqitjet e tij, në parashtrësia, ligjërimi, veprime tjera zyrtare, avokati duhet të dëshmojë kulturë juridike dhe të përgjithshme.

Neni 7

1. Avokati duhet të përvetësojë dhe forcojë besimin e klientit dhe të organeve para të cilave paraqitet.
2. Avokati gjatë ushtrimit të profesionit të tij nuk duhet të bëjë dallime në pikëpamjet politike, partiake apo çfarëdo forme të diskriminimit.

Neni 8

1. Avokati me ndërgjegje i plotëson detyrat e tij, duke ruajtur nderin, respektin dhe dinjitetin e avokatisë.

2. Përgjegjësia e avokatit përfshinë edhe sjelljet dhe veprimet e tij private.

Neni 9

Avokati duhet t'i mbrojë interesat e ligjshme të klientit vetëm me mjete ligjore.

Neni 10

Gjatë përfaqësimit avokati është i obliguar ta ruajë pavarësinë e tij të plotë, të liruar nga çdo trysni, posaçërisht nga ato që dalin nga interesat e tij vetiake ose nga ndikimet e jashtme. Ai duhet t'i shmangët çfarëdo cënimi të pavarësisë së tij dhe të respektojë etikën profesionale.

Neni 11

1. Avokati nuk duhet ti pranojë punët që nuk janë në përputhje me thirrjen e tij dhe që do të dëmtonin pavarësinë, reputacionin dhe prestigjin e avokatisë.
2. Interesi dhe kërkesa e klientit nuk janë arsye për shkelje të Ligjit, Statutit dhe Kodit.

Neni 12

Avokati nuk duhet pa arsye ta refuzojë rastin për të cilin është caktuar sipas detyrës zyrtare nga Oda. Angazhimi sipas detyrës zyrtare bëhet vetëm me ftesë të OAK në harmoni me normativën e saj.

Neni 13

1. Çdo jo lojalitet në afarizëm, është në kundërshtim me këtë Kod, e veçanërisht:
 - a. tërheqja e klientëve nëpërmjet ofertave, ndërmjetësuesve dhe reklamave;
 - b. dhënia e autorizimeve blanko ose materialeve reklamuese;
 - c. bashkëpunimi me persona laik apo persona që ushtrojnë punët e kuazi-avokatisë;
 - d. premtimi i provizionit ose shpërblimit personave tjerë për të tërhequr klientët;
 - e. ushtrimi i veprimtarive të tjera në zyrën e avokatisë;
 - f. mospërfillja dhe fyerja e avokatëve tjerë;
 - g. thirrja në lidhje të ngushta shoqërore, partiake etj.
 - h. thirrja në pozitat e mëparshme (si p.sh. Gjyqtar, Prokuror etj.) përveç në paraqitjen e biografisë së tij.

Neni 14

1. Profesioni i avokatit njëkohësisht nuk ushtrohet me:
 - a. punë apo veprimtari të cilat e bëjnë të padenjë avokatin në ushtrimin e profesionit;
 - b. Asnjë marrëdhënie të rregullt të punës.
2. Avokatit i ndalohet të formojë ortakëri me një person që nuk është avokat në rast se veprimtaria e ortakërisë përbëhet nga ushtrimi i avokatisë.

II. FSHEHTËSIA PROFESIONALE

Neni 15

1. Avokati është i detyruar ta ruaj fshehtësinë për informatat dhe të dhënat e klientit të tij, të cilat i mëson gjatë ofrimit të ndihmës juridike.
2. Avokati duhet të ju kërkoj ortakëve, stafit të tij dhe çdokuj tjetër të angazhuar prej tij, gjatë ofrimit të shërbimeve profesionale, të ruajnë fshehtësinë për informatat dhe të dhënat e klientëve.

Neni 16

Fshehtësi përbën çfarëdo informata të besueshme me të cilat njihet avokati dhe personeli i avokatit në suaza të veprimtarisë duke përfshirë por pa u kufizuar në të gjitha shkresat, shënimet llogaritare, fotografitë dhe shënimet e ngjashme audio dhe video incizimet.

Neni 17

Detyrimi për mbrojtjen e fshehtësisë profesionale nuk është i kufizuar në afat kohor.

Neni 18

1. Avokati mund të zbuloj informatën e klientit, përveç nëse parashihet ndryshe me ndonjë ligj tjetër, apo nëse:
 - a. Klienti jep pëlqimin e tij;
 - b. Zbulimi i informatave paraqet interes shtetëror ose është e domosdoshme për shkak të rrezikimit të integritetit territorial të Kosovës;
 - c. Mbrohet kundër padisë të paraqitur nga klienti;
 - d. Në rast që klienti inicion procedurë penale apo disiplinore kundër avokatit;
 - e. Nëse lënda i jepet subjekteve tjera (eksperti, përkthyesi etj.) për vlerësim dhe analiza me qëllim të përgatitjes së përfaqësimit dhe mbrojtjes ligjore.

III. RAPORTET ME KLIENTIN

Neni 20

1. Avokati mund ta refuzojë dhënien e ndihmës juridike në këto raste:
 - a. Nëse klienti nuk është i gatshëm t'i përmbushë obligimet financiare;
 - b. Nëse avokati e konsideron se rezultati i kërkesës së klientit për ndihmë juridike do të ishte i pasuksesshëm apo i palejueshëm;
 - c. Nëse OAK me vendim të veçantë i ka ndaluar;
 - d. Në rastet që avokati e vlerëson që nuk mund të jetë profesional në çështjen për shkak të ngarkesave me raste të tjera.

Neni 21

1. Me klientin rekomandohet të lidhet kontratë me shkrim për angazhim, kurse detyrimisht kur klienti e kërkon atë.

2. Nëse nuk lidhet kontrata me shkrim atëherë vlenë kompensimi sipas tarifës së OAK-së.

Neni 22

1. Avokati nuk duhet t'i shkaktojë palës shpenzime të panevojshme. Këshillat dhe e mbrojtja e klientit bëhet me ndërgjegje dhe me zell.

2. Avokati sipas nevojës e njofton klientin me zhvillimin e lëndës së tij.

Neni 23

Avokati mund të refuzoj përfaqësimin e klientit nëse e njeh palën kundërshtare. Nëse vendosë t'a marrë përfaqësimin, duhet t'a njoftojë klientin që më parë.

Neni 24

Avokatit të cilit Oda i ka lejuar dhënien e ndihmës së specializuar juridike mund të refuzojë dhënien e të gjitha formave të ndihmës juridike që nuk i takojnë specializimit të tij.

Neni 25

1. Avokati duhet të refuzojë dhënien e ndihmës juridike:
 - a. Nëse ai ose avokati tjetër që ka punuar ose punon në të njëjtën zyrë, të njëjtin rast ose rastin që juridikisht është i lidhur me të e kanë përfaqësuar më parë ose kanë dhënë këshilla dhe udhëzime juridike për palën kundërshtare;
 - b. Nëse në të njëjtën çështje ose në çështjen me të cilën juridikisht është e lidhur, ka punuar si avokat praktikant tek avokati që e ka përfaqësuar palën e kundërt;
 - c. Nëse në të njëjtën çështje ose çështjen që juridikisht është e lidhur me të ka punuar si gjyqtar, prokuror, avokat shtetëror ose si person zyrtar në procedurën administrative apo ndonjë procedurë tjetër;
 - d. Nëse avokati është angazhuar, i njëjti duhet të tërhiqet nga përfaqësimi ose mbrojtja në rast se ekziston rreziku i shkeljes së besimit të klientit të mëparshëm ose në rast se njohja që zotëron avokati për çështjen e klientit të mëparshëm do të përbente epërsi të padrejtë për klientin e ri apo do të ishte në dëm të interesave të klientit të mëparshëm.

Neni 26.

1. Avokati nuk duhet të tërhiqet nga një përfaqësim i ndërmarrë, përveçse kur ka shkaqe të arsyeshme, siç janë:
 - a. Pandershmeria e arsyeve të klientit për të kërkuar asistencë ligjore apo ku kupton se i janë dhënë informacione të pasakta nga klienti;
 - b. Kur klienti insiston që avokati të ndërmarrë veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin ose me kodin e etikës;
 - c. Kur klienti insiston që avokati të ndërmarrë veprime që janë në kundërshtim me vlerësimin e tij profesional;

- d. Kur klienti nuk mund të paguajë për asistencën ose nuk përmbush detyrimet kontraktuale për pagesën e asistencës tashmë të ofruar.

Neni 27

Avokati që ka denoncuar autorizimin është i obliguar ta përfaqësojë palën edhe më tej, derisa pala nuk gjen një avokat tjetër, por më së shumti deri në 30 ditë prej ditës së denoncimit të autorizimit për veprimet që nuk durojnë shtyrje.

Neni 28

Nëse është në interes të palës të cilën e përfaqëson, avokati para fillimit të procedurës apo edhe gjatë procedurës e udhëzon palën e tij që kontesti në mes tyre të zgjidhet me marrëveshje duke i bërë të njohura paraprakisht përparësitë e zgjidhjes së kontestit me marrëveshje.

Neni 29

Avokati ka për detyrë që pas përfundimit të angazhimit në mbrojtje apo në përfaqësim, me kërkesën e palës t'ia kthejë të gjitha shkresat e lëndës pa kushtëzime.

IV. MBROJTJA DHE PËRFAQËSIMI NË ÇËSHTJET PENALE

Neni 30

Avokati është i obliguar të marrë mbrojtjen e ofruar të të pandehurit, pavarësisht nga personaliteti i të pandehurit dhe lloji i veprës si dhe të përfaqësojë palën e dëmtuar në çështjet penale.

Neni 31

Avokati nuk duhet t'a refuzojë mbrojtjen në çështjet penale për shkak se mbrojtja është e vështirë, se ekzistojnë prova të pamohueshme mbi veprën e kryer, se pala ka pranuar kryerjen e veprës, për shkak të peshës së veprës dhe reagimet e opinionit publik.

V. RAPORTET ME ODËN

Neni 32

Avokati ka për detyrë që t'i plotësojë detyrimet e tij ndaj Odës, ta respektojë, ta ruajë dhe ta ngritë autoritetin dhe prestigjin e saj.

Neni 33

Avokati ka për detyrë të marrë pjesë në aktivitetet e organeve të Odës dhe të kontribuojë në mbarëvajtjen e tyre.

Neni 34

Zgjedhja në çfarëdo organi të Odës është nder për secilin avokat dhe zgjedhjen mund ta refuzojë vetëm për shkaqe të arsyeshme. Mos kryerja e detyrave të caktuara dhe të parapara me normativen e OAK paraqet shkelje etike.

Neni 35

Avokati duhet të kujdeset për marrëdhënie të mira kolegjiale ndërsa mosmarrëveshjet eventuale mund të zgjidhen me marrëveshje apo me ndërmjetësimin e organeve të Odës.

Neni 36

1. Shkelje veçanërisht e rëndë e detyrës së avokatit, konsiderohet:
 - a. Moszbatimi i vendimeve të Odës;
 - b. Dhënia e shënimeve të pavërteta OAK dhe organeve të saj;
 - c. Çdo sjellje fyese gjatë korrespondencës me shkrim ose me gojë me këto organe;
 - d. Mos pagesa e anëtarësisë së OAK-së.

VI. RAPORTET ME GJYKATAT, ORGANET ADMINISTRATIVE DHE AUTORITETET TJERA SHTETËRORE

Neni 37

Avokati në kryerjen e profesionit të vet ka për detyrë që gjithnjë të ruajë autoritetin e gjykatave dhe institucioneve tjera në të cilat jep ndihmë juridike dhe të shprehë respektin e duhur ndaj tyre.

Neni 38

Avokati në raport me gjykatën dhe institucionet tjera nuk duhet të japë deklarata fyese ose mendime nënçmuese mbi vendimet e tyre.

Neni 39

Me paraqitjet e tij në raport me gjykatën dhe institucionet tjera avokati duhet të jetë bashkëpunues në zbatimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve dhe të interesave të tyre.

Neni 40

Avokati është i obliguar të kundërshtojë, nëse gjykatësi, prokurori apo personi zyrtar, avokatin, praktikantin ose klientin e tij e trajton si person të nënshtruar.

Neni 41

Avokati duhet ta këshillojë palën e vet që të ju shprehë respektin e duhur subjekteve gjatë procedurës.

Neni 42

Avokati ka për detyrë që palës t'i ofrojë mbrojtje të nevojshme juridike sa më shpejtë që është e mundur.

Neni 43

Avokati duhet ta mbrojë klientin në përputhje me rregullat juridike. Në asnjë mënyrë nuk duhet t'i japë organit ku paraqitet me vetëdije ndonjë informatë të rrejshme e as të ndikoj në dëshmitarë që të japin dëshmi të rreme apo të shtyjë seancat pa ndonjë arsye.

VII. DETYRIMI I INFORMIMIT MBI SHPERBLIMET

Neni 44

Avokati duhet ta njoftojë palën me kërkesën e tij për të gjitha ato që i kërkon si shpërblime për punën e bërë dhe për shpenzimet që mund të krijohen për atë lende. Avokati gjithashtu duhet t'a njoftojë klientin mbi shpenzimet për të cilat ka vendosur gjykata apo organi tjetër dhe që bien mbi palën tjetër.

Neni 45

Avokati ka të drejtë që në fillim të kërkojë nga klienti pagesën për shërbimet e tij.

Neni 46

Nëse klienti kundërshton t'a paguajë për shërbimet dhe ndihmën juridike, avokati mund ta pezullojë punën në rastin e tij pasi e ka paralajmëruar paraprakisht. Avokati ka të drejtë të paguhet për punën që ka bërë deri atëherë sipas Tarifës së Avokatit apo marrëveshjes.

VIII. RAPORTET E AVOKATIT ME PALËN KUNDËRSHTARE

Neni 47

Avokati duhet të sillet me respekt dhe dinjitet edhe ndaj palës kundërshtare.

Neni 48

Avokati nuk mund ta trajtoj çështjen apo të bashkëpunojë me palën kundërshtare pa i njoftuar përfaqësuesit e saj dhe klientin e vet.

Neni 49

Avokati të cilit i ofrohet pala për përfaqësim apo mbrojtje, kundër palës më të cilën avokati ka raporte të ngushta personale është i detyruar që për këtë rrethanë ta njoftojë palën e cila kërkon ndihmë.

IX. RAPORTET RECIPROKE TË AVOKATËVE

Neni 50

Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve duhet të mbështeten në parimin e bashkëpunimit, ndershmërisë dhe konfidencialitetit në interes të klientit. Avokatët në raporte reciproke duhet të reflektojnë mirësjellje dhe qëndrime korrekte në përputhje me normat e etikës profesionale dhe njerëzore.

Neni 51

Avokati duhet të përmbahet nga çdo përpjekje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në synimin që ta tërheqë për vete klientelën e një avokati tjetër.

Neni 52

1. Nëse avokatit i drejtohet pala që e përfaqëson një avokat tjetër, ai është i detyruar t'a informojë kolegun.
2. Kur shpenzimet dhe shpërblimet e avokatit të mëparshëm nuk kontestohen ose nuk janë më objekt kontesti, avokati që e pranon rastin mund t'a marrë përsipër atë lëndë ose të marrë pagesë pa pëlqimin e kolegut të mëparshëm.
3. Në rast kontestimi të shpenzimeve dhe honorarëve ndërmjet avokatit dhe klientit, avokati që e pranon rastin, nuk mund ta marrë përsipër atë lëndë ose të marrë pagese, para se të zgjidhet çështja e përmbushjes së detyrimeve lidhur me shpenzimet e avokatit të mëparshëm. Ky ndalim vlen deri në zgjidhjen e kontestit ose deri sa të bëhet pagesa apo të dorëzohet shuma e kërkuar.

Neni 53

Kur një avokat kërkon që në një lëndë t'a zëvendësojë ndonjëri prej kolegëve ai duhet t'ia dorëzojë menjëherë dosjen me të gjitha shkresat e nevojshme për ta vazhduar punën. Avokati që pranon zëvendësimin ka përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet e tij.

Neni 54

1. Avokati duhet ta zëvendësojë avokatin tjetër që kërkon nga ai zëvendësimin, përveç në rastet kur është i penguar nga punët në lëndët tjera apo ndalesave nga ky Kod.
2. Në rast se nuk ka mundësi ta bëjë këtë punë, avokati duhet ta njoftojë avokatin që ka kërkuar zëvendësimin.
3. Avokati zëvendësues kompensohet nga avokati që ka kërkuar zëvendësimin, sipas tarifës së Odës ose sipas marrëveshjes mes tyre.

Neni 55

Avokati që është caktuar të marrë përsipër lëndën në rastet nga mbrojtja juridike falas apo sipas detyrës zyrtare duhet t'i ndër marrë të gjitha veprimet e domosdoshme.

Neni 56

Nëse dy avokatë të dy shteteve punojnë bashkë, që të dy kanë për detyrë të kenë parasysh ndryshimet e mundshme midis sistemeve të tyre ligjore, Odave të tyre të avokatëve, kompetencave dhe detyrimeve të tyre profesionale.

Neni 57

Për shkak të bashkëpunimit kolegjial, avokati mund të këshillojë një avokat tjetër kur ky i fundit këtë e kërkon, përveç në rast se ky është avokat i palës kundërshtare.

Neni 58

Korrespondenca dhe komunikimi në mes avokatëve është me mirëbesim.

X. RAPORTET ME PRAKTIKANTËT E AVOKATURËS

Neni 59

Avokatët për të krijuar kuadro të afta të jurisprudencës duhet të pranojnë juristë të diplomuar për t'i përgatitur profesionalisht dhe të njëjtit ti trajtojnë me kolegialitet.

Neni 60

1. Avokati duhet ta bëjë raportin me shkrim mbi punën e avokatit praktikant gjatë praktikës. Ushtrimi i praktikës duhet të bëhet me orar të plotë, e jo kohë pas kohe.
2. Avokati nuk duhet ta bëjë raportin mbi një stazh fiktiv të avokatit praktikant.

Neni 61

Avokati duhet ti krijojë avokatit praktikant kushtet e duhura për kryerjen e stazhit të praktikës.

Neni 62

Avokati duhet t'a përcjellë me kujdes aftësimin e praktikantit, të cilit nuk i lejohet kryerja e pavarur e punëve juridike.

Neni 63

Nëse lind kontest në mes avokatit dhe praktikantit ata duhet të përpiqen që kontestin ta zgjidhin me marrëveshje ose me ndërmjetësimin e organeve të Odës.

XI. NDIHMJA JURIDIKE PA PAGESË DHE SIPAS DETYRËS ZYRTARE

Neni 64

Dhënia e ndihmës juridike përfituesve të ndihmës juridike falas që i plotësojnë kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi është detyrë nderi e avokatëve, të cilën duhet t'a bëjnë me kujdes dhe ndërgjegje.

Neni 65

Secili avokat e ka për detyrë që të respektoj procedurën e angazhimit nga OAK në sistemin e ndihmës juridike pa pagesë dhe sipas detyrës zyrtare.

Neni 66

Avokati i cili si përfaqësues nga përfituesit e ndihmës juridike apo sipas detyrës zyrtare, nëse për të njëjtën procedurë kërkon kompensim nga klienti bën shkelje të rëndë të detyrës, këtij kodi dhe të prestigjit të avokatit.

Neni 67

1. Po që se klienti kërkon ndihmën juridike falas avokati duhet t'a njoftojë për këtë mundësi.

2. Avokati duhet të ofrojë ndihmë juridike falas (pro bono) nëse për këtë obligohet nga OAK.

XII. ORGANIZIMI NË ZYRËN E AVOKATIT

Neni 68

Avokati është i obliguar që zyra e tij dhe mënyra e punës në të t'i përgjigjet dinjitetit të profesionit të avokatit.

Neni 69

Avokati ka për detyrë që me kohë dhe me rregull t'i udhëheqë lëndët, arkivojë shkresat, mbajë evidencën e rregullt të afateve dhe gjykimeve.

Neni 70

1. Avokati është përgjegjës për punën e zyrës. Në zyrat e përbashkëta, të gjithë avokatët për punën e zyrës mbajnë përgjegjësi.
2. Avokati mban përgjegjësi për përdorimin e vulës së tij.

Neni 71

Paratë që i ka marrë avokati për klientin, duhet pa vonesa t'ia dorëzojë atij në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 72

1. Nuk lejohet që ti ndalë apo përdorë parat të cilat i janë dhënë me destinim të caktuar përveç nëse mes palës dhe avokatit ka kontratë për shërbimet dhe shpenzimet. Rekomandohet që kontrata të lidhet me shkrim.
2. Nuk lejohet të zgjerohet e drejta e retencionit për shkak të kërkesave të përsëritura për shërbime që duhet ti paguajë klienti më vonë apo kërkesa të pa arritura.

Neni 73

Avokati duhet ti plotësojë të gjitha detyrimet ndaj të punësuarve në harmoni me ligjin dhe me kontratat e punës. Avokati mban përgjegjësi për stafin e punësuar dhe veprimet e tyre në raport me punët e avokatisë.

Neni 74

Avokati duhet të vendosë firmën në ndërtesën në të cilën gjendet zyra e cila as nga forma as nga përmbajtja nuk duhet të shërbejë për qëllime reklamimi dhe komerciale. Gjithashtu, duhet të jetë në harmoni me normativën e OAK.

Neni 75

Avokati duhet të kujdeset që kontaktet dhe konsultimet me palën ti mbajë në zyrën e vet. Përrjashtimisht, avokati mund të kontaktojë dhe konsultojë palën edhe në vende tjera të përshtatshme, por pa e dëmtuar prestigjin dhe autoritetin e avokatit.

Neni 76

1. Avokati mund të paraqitet në media për çështje me interes shkencor ose të përgjithshëm ose përjashtimisht mbi çështje të caktuara, në përputhje me parimet dhe rregullat e përcaktuara me këtë Kod.
2. Në paraqitjet e tilla avokati, mund ta përdorë titullin e tij.

Neni 77

Avokati duhet ti shmanget njoftimit të opinion publik mbi çfarëdo veprimtarie tjetër që do ta cënonte reputacionin e avokatisë.

XIII. REKLAMIMI DHE KERKIMI I KLIENTEVE

Neni 78

Avokatit i lejohe të njoftoj përmes mjeteve të informimit për hapjen dhe ndërrimin e adresës së zyrës. Ky njoftim mund të ju dërgohet institucioneve relevante dhe klientëve.

Neni 79

1. Njoftimi dhe reklamimi mund të përmbajnë:
 - a. CV;
 - b. Informata kontaktuese;
 - c. Arsimimin paraprak;
 - d. Anëtarësinë në ndonjë organizatë profesionale dhe
 - e. Çfarëdo informate tjetër të lejuar nga Oda.
2. Avokatit i lejohe që informatat nga neni paraprak dhe informacionet rreth zyrës, personelit, veprimtarisë dhe kontaktit ti paraqesë në faqen e internetit.
3. Reklamimi nuk duhet:
 - a. Të përmbajë kundërshtime të parimeve dhe detyrimeve të avokatit të përcaktuara me këtë Kod;
 - b. Të përmbajë informacione të rreme, të pasakta ose çorientuese;
 - c. Të bëjë krahasime ose të kritikoj avokat tjerë, veçanërisht mënyrën e kryerjes së profesionit prej tyre.
4. Avokati nuk lejohe:
 - a. Të vendosë shenjën në formë dhe përmbajtje të stërmadhuar apo vendosjen e saj jashtë ndërtesës së zyrës së avokatit;
 - b. Të vendosë titullin e stërmadhuar të specializimit;
 - c. Të paraqitet publikisht me qëllim të imponimit të tij në opinion publik;
 - d. Të afishoj apo vendos në zyrën e tij të dhëna me qëllim të publicitetit;
 - e. Të ofroj shërbime tjera jashtë profesionit të avokatit, përfshirë por pa u kufizuar në përkthime, fotokopjim etj.

Neni 80

Avokati flet vetëm në emër të vet dhe me përgjegjësinë vetanake. Oda e Avokatëve nuk merr kurrfarë përgjegjësie për paraqitjet e tij.

Neni 81

Kërkimi i klientëve ndalohet.

XIV. SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT

Neni 82

1. Avokati ka të drejtë në shpërblim, sipas Tarifës mbi shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatit.
2. Avokati me klientin e tij mundet që të kontraktojë shpërblimin për punën e tij sipas marrëveshjes.

Neni 83

Avokati ka të drejtë, që para se të fillojë angazhimin ti kërkojë klientit t'i paguajë shpenzimet e nevojshme. Nëse pala nuk ia jep avansin për mbulimin e shpenzimeve, avokati mund ta refuzojë angazhimin ose vazhdimin e përfaqësimit.

Neni 84

Avokati mund të kontraktojë shpërblimin me klientin para përfundimit të çështjes. Avokatit i lejohet të kontraktoj shpërblimin për në varësi të suksesit të çështjes në harmoni me legjislacionin relevant.

Neni 85

Avokatit të cilit nuk i është paguar shpërblimi nuk ka të drejtë që palës t'ia ndalë kthimin e shkresave. Është i obliguar që palës në kërkesën e tij t'ia kopjojë shkresat e lëndës.

Neni 86

1. Avokati ka për detyrë që klientit t'ia mundësojë shikimin e Tarifës dhe me kërkesën e tij, t'ia japë llogarinë e specifikuar të shpenzimeve përveç kur shpërblimin e kanë përcaktuar me kontratë.
2. Në rastin e marrëveshjes me shkrim-kontratës avokati duhet t'ia përmbahet kontratës, por nuk është i obliguar që të mbajë dhe të bëjë llogaritjen dhe specifikimin e shpenzimeve për punën e tij.

Neni 87

Avokati nuk duhet t'ia kontraktojë si shpërblim objektin ose pjesën e objektit nga kontesti që i është besuar për përfaqësim. Shpërblimi mund të bazohet vetëm në vlerën e objektit nga kontesti.

XV. HYRJA NË FUQI

Neni 88

Kodi hynë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës.

Kryetari i Odës
Osman Havolli

